



Republika e Kosovës - Republika Kosova	
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica	
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë	
Uprava za Opštë, Administrativne Poslove	
01	Nr./Br. 413101-32674
Data	05.12.2018
Gjakovë - Djakovica - Gjakova	

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Palët pajtohen për bashkëpunim të ndërsjellë

Neni 1

Palët në marrëveshje

Palët e pajtuara për të marrë pjesë në këtë marrëveshje janë:

ASOCIACIONIT TË ARKITEKTËVË TË KOSOVËS - AAK

dhe

KOMUNA E GJAKOVËS

Neni 2

Qëllimi dhe Arsyetimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është, që të përcaktojë fushëveprimin e bashkëpunimit në mes palëve, për realizimin e interesave të dyanshme në fushën e arkitekturës, urbanizmit dhe planifikimit hapësinor, të cilat do t'i kontribuojnë zhvillimit të programit komunal, gjithmonë duke u bazuar në legjislacionin dhe rregulloret e Republikës së Kosovës për fushat e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit, Banimit, Mbrojtjes së Mjedisit, Produkteve dhe Materialeve Ndërtimore si dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

Duke detaujar qëllimin e marrëveshjes nga pasusi i lartshënuar dhe pikat në vijim, palët dakordohen:

Përfituesit e kësaj marrëveshjeje janë komuniteti i arkitektëve të përfaqësuar përmes Asociacionit të Arkitektëve dhe Komuna e Gjakovës me qytetarët e vet.

**Neni 3****Fushëveprimi i bashkëpunimit të palëve**

Kjo marrëveshje mund të bëhet me dije tek të gjitha institucionet dhe individët pjesë e komunitetit të arkitektëve në territorin e Republikës së Kosovës.

Palët pajtohen që Asociacioni i Arkitektëve me përfaqësuesit e vet do të jetë pjesëmarrës në proceset zhvillimore të komunës duke filluar nga planet rregulluese e deri te ato urbane komunale.

Palët pajtohen që, Asociacioni i Arkitektëve do të ofrojë ndihmën profesionale në fazat e ndryshme të implementimit të projekteve kapitale për komunën.

Palët pajtohen që, Asociacioni i Arkitektëve do të ofrojë ndihmën profesionale në përpilimin e detyrave gjatë hartimit të ftesave për konkurse të ndryshme në fushat e lartë-përmendura.

Palët pajtohen që, të bashkëpunojnë në ngritjen e kapaciteteve të reja njerëzore për nevoja të komunës në fushat e lartë-përmendura.

Palët pajtohen që, përveç pikave të lartë-përmendura të bashkëpunojnë edhe në çështje tjera të cilat do t'i rregullojnë me marrëveshje të veçanta.

Palët pajtohen që, parim themelor i bashkëpunimit të jetë profesionalizmi në praktikimin dhe aplikimin e profesionit të arkitektit.

Palët pajtohen që, kjo marrëveshje, do të mundësoj edhe bashkëpunimin më të mirë dhe ndërlidhjen në mes të niveleve komunale dhe qendrore me adresimin e nevojave dhe kërkesave të niveleve si dhe interpretimin dhe trajtimin e duhur që lidhet me ligjin, udhëzimet administrative, rregulloret dhe kodet e ndërtimit.

Kjo marrëveshje do të ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës së palëve.

Palët do të takohen së paku një herë në vit për të analizuar implementimin vjetor të marrëveshjes dhe për të shqyrtuar mundësinë e zgjerimit të fushëveprimit të saj.

**Neni 4**Obligimet dhe Autorizimet

Palët garantojnë që, bashkëpunimi në mes tyre, të realizohet në pajtim me këtë marrëveshje.

Palët obligohen në mirëmbajtjen e ndërsjellët të korrespondencës dhe komunikimit të rregullt.

Palët obligohen në ushtrimin e ndikimit dhe sigurimin e përfaqësimit të drejtë në të gjitha institucionet relevante zhvillimore në vend.

Palët obligohen në koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta në problematikat e legjislacionit i cili lidhet me profesionin e arkitektit me ndikim në zhvillimin e komunës së Gjakovës.

Palët obligohen në koordinimin e përpjekjeve të përbashkëta në njojjen, ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore me theks në arkitekturë si dhe ndërgjegjësimin e publikut për rolin e arkitekturës si pjesë e trashëgimisë kulturore.

Asnjëra nga palët nuk ngarkohet me obligime të veçanta përveç atyre që përcaktohen me këtë marrëveshje.

Palët obligohen që secila palë të caktojë personin përgjegjës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e korrespodencës lidhur me këtë marrëveshje.

Palët pajtohen që obligime specifike të komunës sipas kësaj marrëveshjeje do të jenë në ofrimin resurseve të veta me arë të ofrimit të hapësirave dhe ndihmës financiare për funksionimin e drejtë të Asociacionit të Arkitektëve, posaçërisht anëtarëve që gravitojnë në këtë komunë.

Neni 5Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me përbajtjen e kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhet përmes negociatave ndërmjet palëve.

Neni 6Anulimi

Anulimi i kësaj marrëveshje mund të bëhet me vullnetin e palëve, në rast se njëra prej tyre ka dështuar ta përbush atë.

Neni 7Gjuha e përdorur në marrëveshje

Gjuha e përdorur në këtë marrëveshje është Gjuha Shqipe.

Neni 8Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje është 2(dy) vite.

Nëse kjo marrëveshje nuk anullohet, do të vazhdohet automatikisht çdo 2 (dy) vite.

Neni 9Numri i ekzemplarëve

Kjo marrëveshje është e hartuar në 4(katër) ekzemplar, nga dy për secilën palë nënshkruese.

PALËT NËNSHKRUÉSE

Për

Asociacionin e Arkitektëve të Kosovës

Për

Komunën e Gjakovës

